




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Drejtoria për Kulturë në Komunën e Prishtinës
duke u mbështetur në Vendimin për Kriteret dhe procedurën e ndarjes së subvencioneve
nr. 01-091-112404 të dt. 12.05.2014, u bën

THIRRJE

individëve, organizatave dhe bizneseve që të aplikojnë me projekt propozime në fushën e MUZIKËS që do të realizohen në Komunën e Prishtinës. Të interesuarit duhet të përmbushin kriteret si në vijim:

- Të plotësojnë dhe dorëzojnë të nënshkruar formularin për aplikim, i cili mund të shkarkohet nga ueb faqja e Komunës;
- Të përfundojnë realizimin e projektit deri me 30 qershor 2017;
- Të prezantojnë dëshmi për sigurimin e 30% të fondeve të planifikuara;
- Të dorëzojnë të gjitha dokumentet e kërkuara në formularin për aplikim.

Shpenzime të cilat nuk do të mbështeten janë ato administrative, renovime, blerje të pajisjeve, dhurata, shpërblime dhe të ngjashme.

Projekt propozimet mund të dorëzohen në zyrën pritëse, sporteli nr.5 në Komunën e Prishtinës (objekti i vjetër) deri më **20 shkurt 2017**.

Formulari për aplikim mund të shkarkohet vegzën: <http://kk.rks-gov.net/prishtina/Municipality/Departments/Kultures,Rinise,Sportit/Subvencionet/Subvencione/Formularet-per-aplikim.aspx>

VËREJTE: Projektet të cilat nuk i kanë të bashkangjitura dokumentet sipas kërkesës si dhe projektet e palëve të cilët nuk kanë përmbyllur projektet nga fazat paraprake nuk do të merren parasysh nga Komisioni për shqyrtimin e kërkesave.

Për çdo informatë shtesë ju lutem na shkruani në kultura.pr@rks-gov.net